

VENDIM
Nr. 26/2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 74/2018 “PËR NGRITJEN
E KOMISIONIT TË PAVARUR PËR KOORDINIMIN, MONITORIMIN DHE
NDJEKJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES
SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, e Kushtetutës, të nenit 288 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe të nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozim deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Pika X e vendimit të Kuvendit nr. 74/2018 “Për ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë””, ndryshohet si më poshtë:

“X. Masa e Shpërblimit të anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” vendoset si më poshtë:

a) Kryetari i Komisionit të Pavarur, për çdo mbledhje, në të cilën është prezent, përfiton shpërblim në masën prej 30 për qind të pagës mujore bruto të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor/ Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

b) Anëtarët Komisionit të Pavarur, për çdo mbledhje, në të cilën janë prezent, përfitojnë secili shpërblim në masën prej 25 për qind të pagës mujore bruto të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor/ Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë;

c) Staf i Kuvendit, që angazhohet me veprimtari në mbështetje të Komisionit të Pavarur, përfiton shpërblim mbi pagën në masën e vendosur nga Byroja e Kuvendit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet që prej ditës së emërimit të anëtarëve të Komisionit të Pavarur.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 31.1.2019.